



BAROMETRI KOMBËTAR I LIRISË SË MEDIAS NË SHQIPËRI 2021



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri Për vitin 2021

Tiranë, Tetor 2022

Pyetësi dhe Metodologjia:

Znj. Fatjona Mejdini, Eksperte e medias

Zbatimi i metodologjisë dhe përgatitja e raportit:

Z. Vladimir Karaj, Gazetar
Znj. Ola Mitre, Gazetare

Redaktim ligjor:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive,
KSHH
Znj. Roven Vuksani
Koordinatore Projekti, KSHH

Publikuar nga:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rruga “Brigada e VIII”, Kulla
“Tekno Projekt”, Shkalla 2,
Apartamenti 10, Kati 6



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

© 2022 Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Ky raport u hartua në kuadër të projektit “Forcimi i Standardeve të Integritetit të Medias në Shqipëri” mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar nga East -West Management Institute.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH) dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e East-West Management Institute dhe/ose Ambasadës Britanike në Tiranë.

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	3
2. Përmbledhje ekzekutive	5
Të drejtat dhe kushtet e punës	6
Vetëvlerësimi i lirisë së medias	7
3. Metodologjia.....	10
5. Respektimi i të drejtave të gazetarëve në vendin e punës.....	15
5.1. Informaliteti në punë	15
4.2. E drejta për pushime javore dhe vjetore.....	16
4.3. Bullizmi/tallja në vendin e punës	17
4.4. Ngacmimet seksuale në vendin e punës	18
4.5. Nevoja për krijimin e Sindikatës së Punonjësve të Medias	18
6. Liria profesionale.....	19
6.1 Kërcënimet për shkak të punës	19
6.2. Stresi dhe situatat traumatike	21
6.3. Censurë dhe vetëcensurë.....	21
7. Vlerësimi i lirisë së medias	23
7.1. Perceptimi mbi lirinë e medias dhe tendenca, me vitet e kaluar	24
.....	24
7.2. Ngjarjet (faktorët) ndikues	24
7.3. Gazetaria Cilësore.....	25
7.4. Aksesit në Gjykatë.....	26
7. Rekomandime.....	28

1. Hyrje

Në përputhje me misionin e tij, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) ndërtoi dhe zbatoi për të dytin vit radhazi “Barometrin Kombëtar të Lirisë së Medias në Shqipëri për vitin 2021”.

Barometri përpunon dhe analizon nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, të dhënat e përftuara nga një sondazh i realizuar me gazetarët dhe punonjësit e media, sa i përket situatës së kushteve të tyre të punës, lirisë profesionale dhe perceptimet e tyre mbi lirinë e medias në tërësi në Shqipëri.

E garantuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë¹ të vitit 1998, liria e shprehjes, shtypit, radios dhe televizionit si dhe e drejta për informim, vijojnë të sfidohen qoftë prej politikës, institucioneve, biznesit, por edhe segmentë të krimit të organizuar në vend. Pavarësisht se kanë kaluar 30 vjet nga rënia e regjimit totalitar, liria e shprehjes në Shqipëri dhe të drejtat e gazetarëve e punonjësve të medias nuk garantohen dhe respektohen plotësisht. Në Shqipëri, pavarësisht detyrimit të për të zbatuar një sërë Konventash ndërkombëtare të ratifikuara, që vendosin një standard minimal për mbrojtën e të drejtave dhe lirive të njeriut, të dhënat e sondazhit të analizuar në këtë Barometër hedhin dritë në problematikat lidhur me lirinë e shprehjes në tërësi, me një impakt të drejtpërdrejtë në lirinë e medias.

Pas përmirësimeve për disa vite me radhë në “Indeksin e Lirisë Botërore të Shtypit” të publikuar nga “Reporterët pa Kufij”, prej vitit 2019 Shqipëria ka pësuar vazhdimisht rënie, kryesisht për shkak të përpjekjeve të qeverisë për të kontrolluar median duke e formalizuar edhe në formën e rregulloreve apo legjislacionit të caktuar. Të dhënat nga raporti i fundit i “Reporterëve pa Kufij” e rëndisin Shqipërisë në vendin më të ulët në 10 vitet e fundit². Nga pozicionimi në vendin e 83-të për vitin 2021, Shqipëria ra në vendin e 103-të nga 180 vende të vlerësuara, duke reflektuar kështu një rënie prej 20 vendesh. Në tërësi, Reporterët Pa Kufij nënvizojnë se ndërsa pavarësia editoriale kërcënohet nga rregullimi partizan i medias, integriteti fizik i gazetarëve minohet nga krimi i organizuar, dështimi i shtetit për t'i mbrojtur ata dhe madje edhe nga dhuna policore. Lidhur me kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë, Reporterët pa Kufij shprehen se prokurorët shqiptarë kanë ndaluar mediat të pasqyrojnë çështje me interes publik si dhe u kërkohet autoriteteve të shmangin masat joproporcionale, duke shprehur keqardhjen për faktin që gazetarët janë kërcënuar me burgim për shkeljen e këtyre ndalimeve. Reporterët pa Kufij dhe organizata të tjera për lirinë e shtypit protestojnë kundër vendimit të Kryeministrit për të ndaluar gazetarët nga konferencat për shtyp, ndërkohë që i kërkohet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të hedhë dritë mbi shkeljet e privatësisë dhe frikësimin e të paktën dy gazetarëve që hetuan procesin e vettingut të Kryeprokurores së Tiranës, Elizabeta Imeraj. Vlen të theksohet se përkeqësimi është në raport të zhdrejtë edhe me situatën në vendet fqinje, që përveç Greqisë, që humbi 38 vende, kanë njohur të gjitha përmirësim, përfshirë edhe Kosova e cila pozicionohet 42 vende më lart se Shqipëria.

Nga ana tjetër, raporti mbi lirinë e medias nga “Freedom House” për vitin 2021, i dha Shqipërisë një pikë shtesë, duke e vlerësuar me 67 pikë nga 100 lirinë e medias në vend. Pavarësisht se nuk evidentoi përkeqësim të situatës, Freedom House nuk gjeti asnjë përmirësim në lirinë e pavarësinë e medias, që u vlerësua me vetëm dy pikë nga katër, duke mos reflektuar asnjë ndryshim në raport

¹ parlament.al/Files/sKuvendi/kushtetuta.pdf

² <https://rsf.org/en/ranking>

me vitin e shkuar.³ Gjithashtu, kjo organizatë vëren njësoj si një vit më parë se “gazetarët kanë pak siguri në punë dhe mbeten subjekt i padive, kërcënimeve dhe sulmeve të herëpashershme fizike nga ata që përballen me shqyrtimin e mediave. Ndërkohë që media e shkruar ka vazhduar të përjetojë rënie të të ardhurave, gjë që ka ulur pagat e gazetarëve”.⁴

Tërheqja e qeverisë nga dy ligjet pjesë e paketës “antishpifje”, pasi ajo u kritikua që në fazat e hershme të hartimit të saj nga organizatat e shoqërisë civile⁵, Këshilli i Evropës, Këshilli i Bashkimit Europian⁶, u pasua nga lëvizje të ngjashme që vlerësohen nga ekspertët e medias si tkurrëse për median, siç ishte krijimi i “Agjencisë për Media dhe Informim” me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.512, dt.18.09.2021. Agjencia “ka si mision të sigurojë transparencën në lidhje me politikën, aktivitetet, projektet, eventet, si dhe qëllimin, objektivat, risitë apo problematikat që zgjidhen nëpërmjet akteve të Këshillit të Ministrave dhe të akteve të tjera të ministrave dhe çdo institucioni të administratës shtetërore”. Krijimi i kësaj agjencie u kundërshtua nga disa organizata të shoqërisë civile, të cilat ndajnë shqetësimet se në vend që të përmirësojë aksesin e gazetarëve të informacionit publik, Agjencia mund të bëjë saktësisht të kundërtën⁷. Ekspertë të medias shohin me nota kritike ndër të tjerash, pikën 10, gërma “n” të VKM-së, ku parashikohet përgjegjësia e Agjencisë për të siguruar përgjigje për shkresat dhe kërkesat për informacion, në lidhje me çështjet e informimit dhe komunikimit mediatik apo çështje të tjera në fushën e saj të përgjegjësisë. Duke qenë se Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra nga kryeministri, dhënia e informacionit për gazetarët do të centralizohet dhe marrja e tij do të jetë më e vështirë, pasi do të jenë punonjësit e Agjencisë të cilët vendosin për të dhënë ose jo informacionin e kërkuar prej saj⁸.

³ <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022>

⁴ <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022>

⁵ <https://citizens-channel.com/2020/01/30/organizatat-nderkombetare-thirrje-qeverise-shqiptare-per-te-mos-votuar-paketen-anti-shpifje/>

⁶ Konkluzione të Këshillit mbi zgjerimin dhe stabilizimin dhe procesin e asociimit - Shqipëria dhe Republika e Maqedonisë së Veriut, Këshilli i Bashkimit Europian, 2020, <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

⁷ reporter.al/2021/10/11/organizatat-e-medias-i-kerkojne-rames-te-heqe-dore-nga-agjencia-e-medias/

⁸ <https://www.dw.com/sq/shqip%C3%ABri-ami-p%C3%ABr-m%C3%ABshum%C3%ABtransparenc%C3%ABapo-kontroll/a-59333185>

2. Përmbledhje ekzekutive

Barometri i “Lirisë së Medias” që realizohet në Shqipëri nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), me ndihmën e ekspertëve të fushës, për të dytin vit radhazi konfirmon gjendjen jo të mirë të medias dhe lirisë së shprehjes në vend.

Situata vijon të mbetet problematike si përsa i përket lirisë së medias ashtu edhe kushteve të punës me të cilat përballen punonjësit e medias në vendin tonë. “Tërheqja” në parim nga paketa e ashtëquajtur “anti-shpifje”, miratimi agjencisë që centralizon edhe më tej shpërndarjen e informacionit, transmetimi i lajmeve të prodhuara nga forcat politike dhe gjuha e vazhdueshme me nota fyese dhe diskretituese ndaj gazetarëve dhe medias, raportohen si shenja të një situatë që nuk reflekton përmirësime.

Analiza e të dhënave të grumbulluara nga Barometri konfirmon se pavarësisht se informaliteti në radhët e punonjësve të medias ka pësuar një ulje të vogël në krahasim me një vit më parë, punëdhënësit në sektor nuk respektojnë kërkesat ligjore të Kodit të Punës, veçanërisht sa i përket raportit midis ditëve të punës dhe atyre të pushimit. Shumica absolute e raportuesve të pyetur me anë të Barometrit e konsiderojnë të domosdoshëm një orgaizim sindikal të fuqishëm në sektorin e medias, por thuajse po e njëjta përqinde (me një diferencë më të vogël) hezitojnë të anëtarësohen në këtë sindikatë, duke menduar për pasojat që mund të vijnë nga pronarët e medias.

Barometri i vitit 2021 evidenton rritje të rasteve të kërcënimit fizik dhe verbal ndaj gazetarëve e punonjësve të media. Pavarësisht se ka një rënie të lehtë në raport me një vit më parë, vijon të jetë shqetësues fakti se afro një në dy gazetarë janë censuruar nga struktura hierarkike dhe drejtuese e redaksisë dhe po kaq, prej tyre kanë pësuar vetë-censurë. Ndërkohë, pjesa më e madhe e të anketuarve apo 68% e tyre (2.5% më shumë se vitin e shkuar) perceptojnë se media në Shqipëri është pak ose aspak e lirë. Përfaqësues të politikës në nivel qendror apo vendor mbeten sërish censuruesit dhe kufizuesit kryesorë të lirisë së medias sipas të anketuarve, të ndjekur sërish nga pronarë të medieve, përfaqësues të strukturave shtetërore, kryesisht ato policore dhe persona të identifikuar si të përfshirë apo implikuar në krim.

Sa më sipër dhe një sërë problemesh që vijuan të ishin thuajse të pandryshueshme edhe në vitin 2021, kanë krijuar klimë negative për lirinë e medias në vendin tonë si një mjedis të pasigurt, censurë dhe vetë-censurë, mungesë e stabilitetit ekonomik apo formalizimi i marrëdhënieve të punës. Këto problematika, të pazgjidhura në thelb kërkojnë një adresim të qartë jo vetëm tek institucionet shtetërore përgjegjëse, apo institucionet e pavarura (AMA) por edhe në strukturat vet-rregulluese të medias. Secila prej tyre, dhe duke bashkëpunuar të gjitha së bashku mund të kontribuojnë për të përmirësuar mjedisin e për të garantuar lirinë e medias, si një nga kushtet për demokraci funksionale.

Barometri i Lirisë së Medias për vitin 2021, duke qenë i dyti i kësaj natyre, ofron një mundësi krahasimi me situatën e një viti më parë, ku vlen të theksohet se edhe pse ndryshimet në perceptim janë të vogla nga një vit në tjetrin, ato nuk janë domethënëse për të ndryshuar klimën e përgjithshme të lirisë së medias dhe kushtet në të cilat punojnë gazetarët dhe punonjësit e tjerë në media.

Për efekt të strukturës dhe krahasimit mes gjetjeve të dy viteve kur është realizuar matja, gjetjet e Barometrit për vitin 2021 mbeten sërish të ndara në tri seksione. Seksioni i parë përmban të dhëna konkrete mbi gjendjen dhe respektimin e të drejtave të gazetarëve në vendin e punës. Në seksionin e dytë gjenden të dhëna mbi situatën dhe faktorët që ndikojnë në lirinë profesionale të gazetarëve dhe punonjësve të medias. Ndërkohë që, seksioni i tretë paraqet të dhëna mbi faktorët që ndikojnë në cenimin e lirisë së medias sipas punonjësve të sektorit, si dhe sugjerimet e tyre mbi masat dhe ndërhyrjet që do të kontribuonin më shumë rritjen e lirisë së medias.

Të drejtat dhe kushtet e punës

- *Liria sindikale*

Gjetjet e Barometrit 2021 reflektojnë se shumica dërrmuese e punonjësve të medias mendojnë se rritja profesionale dhe organizimi në sindikata do të ndihmonin drejtpërdrejt gazetarët dhe do të përmirësonin si lirinë e medias ashtu dhe kushtet e tyre të punës. Konkretisht, 194 prej punonjësve të anketuar apo 97% e tyre janë pro ngritjes së sindikatës por megjithatë vetëm 85.5% e tyre shprehën gatishmërinë të ishin pjesë aktive e saj, duke reflektuar një qasje hezituese për shkak të klimës intimiduese prej punëdhënësve të tyre.

- *Informaliteti në punë*

Informaliteti në punë reflekton përmirësim të situatës, pasi 84% e të anketuarve pohuan se punojnë bazuar në një kontratë të rregullt pune, duke dëshmuar një përmirësim në masën 15%, në raport me të dhënat e Barometrit të vitit 2020. Megjithatë, vlen të theksohet se numri i atyre që punojnë pa kontratë mbetet sërish i lartë, pasi rreth 16% u përgjigjën se nuk kanë një kontratë të rregullt pune apo nuk kanë informacion për marrëdhënien e tyre kontraktuale, edhe pse një nivel i përmirësuar në masën 14%, në raport me të dhënat e një viti më parë.

- *Bullizimi/tallja⁹ në vendin e punës*

Bullizimi apo tallja në vendin e punës mbetet në nivele pothuajse të njëjta me vitin e shkuar, duke reflektuar një rritje me vetëm 1% të të anketuarve, në total 12.5% e tyre pohojnë se janë bullizuar/tallur gjatë punës apo për shkak të saj, në ambientin e punës. Në këtë kategori, shumica e tyre pohuan se kishin më shumë se 10 vite përvojë në punë, ndërsa fenomeni raportohet si nga femrat, ashtu dhe nga meshkujt, duke mos e reflektuar si një problem me bazë gjinore bullizimin në vendin e punës.

- *E drejta për pushime javore dhe vjetore*

⁹ “**Bullizmi**” është përdorimi i forcës, shtrëngimit, ngacmimeve ose kërcënimeve lënduese apo që shkaktojnë dhimbje, me synimin për të abuzuar, dominuar ose frikësuar në mënyrë agresive. Sjellja shpesh përsëritet dhe bëhet e zakonshme. Një parakusht thelbësor është perceptimi (nga ngacmuesi ose nga të tjerët) i një ç’ekuilibri të pushtetit fizik apo shoqëror. Ky ç’ekuilibër e dallon ngacmimin nga konflikti. Burimi për referimin e këtij përkufizimi është marrë nga Juvonen, J.; Graham, S. (2014). "Bullying in Schools: The Power of Bullies and the Plight of Victims". *Annual Review of Psychology*. 65: 159–85.

Duke marrë në konsideratë të drejtën e punëmarrësve për pushime javore dhe vjetore të garantuara nga Kodi i Punës, nga anketimi rezulton se:

- 63.5% e punonjësve të medias deklarojnë se punojnë 6 ditë në javë, një përqindje më e lartë se ajo e vitit të kaluar, përkatësisht me 59%. I lartë mbetet edhe numri i atyre që nuk bëjnë pushim javor (14.5%).
- Vetëm 34% e punonjësve gëzojnë efektivisht të drejtat për pushime vjetore. Kjo e dhënë tregon një përmirësim në krahasim me gjetjet e vitit të shkuar kur kjo shifër ishte vetëm 16.5%. Treguesi reflekton pozitivisht edhe gjetjet e përmendura me herët, për formalizimin e marrëdhënieve të punës me anë të kontratave.

- *Kërcënimet për shkak të punës*

Shqetësuese mbeten të dhënat lidhur me kërcënimet fizike dhe verbale ndaj gazetarëve e punonjësve të medias. Barometri i vitit 2021 evidenton raste të shpeshta të kërcënimit fizik dhe verbal ndaj gazetarëve e punonjësve të medias. I njëjti konstatim është vërejtur edhe gjatë vitit 2020. Të dhënat e mbledhura tregojnë një rritje gjatë vitit 2021, me 1.5% të gazetarëve që janë përballur me kërcënime fizike apo verbale. Konkretisht 34.5 % e të anketuarve raportuan se ishin kërcënuar fizikisht ndërkohë që 52.5% raportojnë kërcënime verbale për shkak të punës apo gjatë kryerjes së saj. Kërcënuesit gjithashtu mbeten të njëjtë nga vështrimi krahasues për vitet 2020 – 2021, ku konfirmohen punonjësit e policisë, protestuesit, persona të dyshuar për lidhje me botën e kriminit apo persona të përfshirë në një ngjarje. Gazetarët raportojnë tentativa që i kanë penguar në ushtrimin e profesionit si ato për dëmtimin e mjeteve të punës, shtyrje, ndalime nga policia, etj. Vijon të mbetet shqetësues fakti se nuk raportohen të dhëna për ndëshkimin e autorëve të dhunës.

- *Stresi dhe situata traumatike*

Punonjësit e medias vijuan të raportonin nivele të larta stresi për shkak të punës. Rreth 68.5% e të anketuarve ose 11% më pak se një vit më parë, raportuan se kishin mbuluar dhe raportuar ngjarje që u kishin shkaktuar tronditje të fortë psikologjike. Megjithatë kërkitimi i ndihmës mjekësore për këto situata mbetet thuajse tabu dhe vetëm 6% e punonjësve të pyetur pohuan se kishin kërkuar ndihmë mjekësore apo psikologjike.

- *Censurë dhe vetëcensurë*

Sa i takon censurës dhe vetëcensurës, krahasuar me Barometrin e kaluar, ka një përmirësim të lehtë të situatës, pavarësisht se shifrat vijnë të jenë shqetësuese në kuptim të garantimit të lirisë së medias në vendin tonë. Nga të dhënat e Barometrit 2021, 45.5% e të anketuarve pohuan se u ishte kërkuar direkt apo përmes redaktorit apo kryeredaktorit të mos publikonin një lajm (5% më pak se vitin e shkuar) dhe po kaq, 45% e tyre pranuan të ishin vetëcensuruar. Arsyet pas censurës mbeten të njëjta dhe lidhen me interesa të punëdhënësit sa i takon ndikimeve të rrethit shoqëror, biznesit dhe në raport me funksionarë publikë.

Vetëvlerësimi i lirisë së medias

Ndryshe nga qëndrimet sa i përket censurës dhe vetëcensurës, perceptimi për lirinë e medias në tërësi shënon një trend të lehtë përkeqësimi në raport me një vit më parë. Panorama e përgjithshme lidhur me vetëvlerësimin përbën një indikator tepër shqetësues për perceptimet e gazetarëve dhe punonjësve të medias për lirinë e medias në vendin tonë.

Pjesa më e madhe e të anketuarve apo 68% e tyre (2.5% më shumë se vitin e shkuar) perceptojnë se media në Shqipëri është pak ose aspak e lirë. Ndërkohë që 28% vlerësojnë se media është mesatarisht e lirë. Vetëm 4% e të anketuarve mendojnë se media në vend është e lirë apo plotësisht e lirë. Gjysma e të pyeturve (50%) e shohin situatën e medias në vend në përkeqësim.

- *Faktorët ndikues*

Të anketuarve iu ofruan disa alternativa për faktorët që në vlerësimin e tyre kanë ndikuar në cenimin e lirisë së medias gjatë vitit 2021. Të dhënat evidentojnë se:

- 83% e të anketuarve perceptojnë se ndërhyrjet e qeverisë apo partive politike konsiderohen si faktori kryesor që cenon lirinë e medias (duke reflektuar një rënie me 7% nga viti i kaluar).
- në masën 78.5% (apo 1.5% më pak) renditen interesat e bizneseve të drejtuara nga pronarët e mediave.
- bizneset që reklamojnë në media dhe ushtrojnë ndikim negativ ishin të tretët me 35%, ndërkohë që vihet re një rritje me 11.5% duke çuar në zgjedhjen në masën 33%, të faktorit ndikues të përdorimit të medias për t'u pasuruar.

- *Gazetaria cilësore*

Sipas të anketuarve (30% e tyre) gazetaria cilësore ka qenë më shumë prezentë në media në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, duke pasqyruar një rritje me 7% nga një vit më parë. Megjithatë numri i atyre që e shohin gazetarinë si të ngecur në vend apo në rënie është sërish më i lartë. Për 70% të të anketuarve, gazetaria cilësore shënon nivele të njëjta ose rënie gjatë 2021-it. Faktorët ndikues për vitin 2021 janë:

- situata e krijuar nga pandemia që vijoi edhe përgjatë vitit 2021,
- ndikimi i qeverisë dhe politikës në media,
- zgjedhjet parlamentare, të zhvilluara në 25 prill 2021 u përmendën gjithashtu si një faktor ndikues në rënien e gazetarisë cilësore.

- *Pengesat për t'iu drejtuar gjykatës kur çënohet liria e shprehjes*

Punonjësit e medias reflektojnë arsye të ngjashme si të një vitit më parë, sa i takon pengesave për t'iu drejtuar gjykatës për të patur një mjedis që j'u garanton lirinë e shprehjes. Burokracia në përballjen me gjykatën është faktori kryesor sipas të anketuarve (63.5% të rasteve), ndjekur nga frika nga hakmarrja e punëdhënësit (55.5%). Me ndryshime të papërfillshme, këto të dhëna mbeten thuajse të njëjta me gjetjet në Barometrin e vitit 2020.

Veç kontributit nga gazetarët dhe punonjësit e medias në Shqipëri, një pjesë e të dhënave zyrtare në Barometër janë edhe informacioni i marrë në rrugë zyrtare nga gjykatat e rretheve gjyqësore sa i takon numrit të çështjeve gjyqësore në proces, të pushuara apo të pezulluara me palë gazetar apo punonjës të medias. Nga 21 gjykata rrethesh të kontaktuara nga KShH, të cilat kanë kthyer përgjigje zyrtare, 15 prej tyre kanë referuar se për periudhën Janar – Dhjetor 2021 nuk kanë pasur çështje gjyqësore si edhe nuk janë dhënë vendime me palë përfaqësues të medias apo gazetarë. Gjykatat që referojnë se kanë patur apo vijojnë të kenë procese të tilla janë si vijon:

1. **Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier** rezulton një çështje e regjistruar me palë gazetar, për kundravajtjen penale “Fyerja”. Gazetari ka qënë palë në këtë proces në cilësinë e të dëmtuarit akuzues. Ndërkohë, po për të njejtën periudhë, në këtë gjykatë rezulton të ketë pasur edhe një çështje civile me palë paditëse gazetarë, me objekt “*Marrëdhënie pune*”, për të cilën është marrë edhe një vendim. Një vendim tjetër i kësaj gjykate ku njëra nga palët ka qënë gazetar, rezulton të jetë çështja me objekt “*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*”, megjithatë në përgjigjen e gjykatës referohet se ky rast nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë me profesionin e të pandehurit.
2. **Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat** referohet një çështje në gjykim për veprën penale “*Shpifja*” ku palë të paditura janë dy televizione.
3. **Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**, ka një çështje me palë një individ të profesionit gazetar, akuzuar për veprën penale “*Shpifja*” e cila është aktualisht në shqyrtim nga kjo gjykatë. Kjo është një çështje e mbartuar nga viti 2020.

Ndërkohë Gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër, Durrës dhe Tiranë vijojnë të referojnë problematike, ashtu si për vitin 2020, faktin se për shkak të mënyrës së grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, nuk mund kryhet një cilësim i profesionit të palës dhe për pasojë nuk e kanë të mundur të evidentojnë çështjet me palë gazetarë apo punonjës të medias.

- *Faktorët që kontribuojnë në rritjen e lirisë së medias*

Përzgjatë sondazhit, të anketuarve iu kërkua të përzgjidhnin 3 faktorë, të cilat sipas tyre, kontribuojnë për garantimin e lirisë së medias në vendin tonë. Nga përpunimi i të dhënave vërehet se:

- Me një rritje prej 3 % nga të dhënat për vitin 2020, punonjësit e medias në masën 66% pohojnë si faktorin kryesor nevojën që të krijohet një sindikate që ti përfaqësojë dhe mbrojë denjësisht ata;
- Për 62.5% të tyre, megjithëse me një rënie prej 3.5%, faktor për rritjen e lirisë së medias referohet përgatitja më e mirë profesionale e gazetarëve (nëpërmjet trajnimeve, forcimit të integritetit profesional, etj);
- Më shumë se gjysma e të anketuarve (56%), pohojnë se është e nevojshme mbështetja e mediave nga donacione të huaja.

Duke marrë në konsideratë perceptimet e punonjësve të medias dhe shqetësimet që ata ndajnë për lirinë e medias në vendin tonë, KShH ka evidentuar në përfundim të këtij Barometrit, me ndihmën e ekspertëve të angazhuar, disa rekomandime që mund t’i shërbejnë përmirësimit të situatës në të

ardhmen. Rekomandimet reflektojnë sërish problematikat e identifikuara në Barometrin e vitit të kaluar duke rezultuar në një mungesë reagimi konkret të të gjithë aktorëve të përfshirë.

3. Metodologjia

Të dhënat e Barometrit 2021 janë marrë duke përdorur kryesisht metodën e sondazhit. Për realizimin e tij është shpërndarë një pyetësor, i cili përbëhej nga 47 pyetje (të mbyllura dhe/ose të hapura, të hartuar nga ekspertë të medias dhe të rishikuar më pas nga KSHH). Metodologjia e mbledhjes së të dhënave është e njëjtë me Barometrin e vitit 2020. Gjithashtu, edhe pyetësi nuk ka pësuar asnjë ndryshim në përmbajtje, në krahasim me atë të përdorur vitin e kaluar, çka mundëson mbledhjen e të dhënave të njëjta dhe një krahasim të saktë të të dhënave ndër vite.

Për realizimin e sondazhit, dy ekspertë të medias kontaktuan në rrugë elektronike dhe telefonike, përkatësisht 380 punonjës të medias (gazetarë, kryeredaktorë, redaktorë, regjisorë, operatorë, montazhierë, etj.). Pyetësi është ndarë me të anketuarit në format elektronik, çka i ka mundësuar të interesuarve ta plotësojnë në mënyrë të pavarur, të pandikuar dhe në mënyrë anonime. Garantimi i anonimitetit u vlerësua nga ekspertët e medias se nxiti një nivel më lartë të reagimit pozitiv për t'iu përgjigjur Barometrit, pasi të anketuarit do të ndiheshin të lirë dhe jo të paragjykuar për përgjigjet e dhëna. Pas mbledhjes së të dhënave, përgjigjet për pyetjet e mbyllura janë përpunuar në formën statistikore, ndërkohë që përgjigjet e hapura, janë analizuar nga pikëpamja cilësore nga dy ekspertët e angazhuar. Gjithashtu, përgjatë analizës në Barometrin 2021, është përdorur edhe metoda krahasimore me të dhënat e një viti më parë, për të gjurmuar ndryshimet në situatën e lirisë së medias.

Interesit për Barometrin i janë përgjigjur 200 punonjës të sektorit të medias. Vlen të theksohet se, kampioni i përzgjedhur, pavarësisht se është i konsiderueshëm nuk mund të krahasohet objektivisht me numrin total të punonjësve të sektorit të medias në vendin tonë. Aktualisht mungojnë të dhëna të sakta lidhur me këtë tregues. Referuar botimeve të organizatave të shoqërisë civile apo ekspertëve të fushës, evidentohet se në vitin 2019, pati një rënie të numrit të punonjësve të medias, nga 6200 në 5900 vetë. Mungesa e shifrave të sakta konfirmon sërish informalitetin në media. Ndërkohë për rënien në vijim të numrit të gazetarëve mund të ketë ndikuar edhe mbyllja e një pjese të mirë të gazetave apo revistave, por edhe largimet e gazetarëve nga profesioni për shkak të pakënaqësive me kushtet e punës.¹⁰

Metodologjia e kampionimit ka si qëllim gjithëpërfshirjen e gazetarëve dhe punonjësve të medias duke marrë në konsideratë elementë si gjinia dhe shpërndarja gjeografike, ku të anketuarit ishin të pozicionuar në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Vlorës, Fierit, Shkodrës, Elbasanit, Durrësit, Pogradecit, Lezhës, Kukësit, Kavajës, Librazhdit dhe Lushnjes. Për shkak të natyrës së pyetjeve, një numër shumë i lartë i përgjigjeve ka ardhur nga gazetarë (rreth 85%), ndërkohë që i janë përgjigjur në minorancë, punonjës të tjerë të sektorit të medias (në pozicione regjizor, montazhier, kameramanë, teknikë transmetimi, etj.). Lidhur me mediat ku të anketuarit janë të punësuar, të parët më të përfaqësuar në të dhënat që Barometri janë punonjësit e televizioneve, ndjekur nga punonjësit e portaleve online, kjo edhe për shkak të rënies së numrit të gazetave dhe revistave. Në Barometrin e vitit 2021 kjo diferencë është thelluar edhe më tepër.

¹⁰ Open Society Foundation, Peizazh i medias online në Shqipëri. Tiranë: OSFA, 2018 Kabashi, Gëzim. “Kosotot e dixhitalizimit mbyllin televizionet lokale”. BIRN, Nëntor 9, 2019

Sondazhi u realizua gjatë periudhës Prill – Maj 2022, por të dhënat e tij i referohen periudhës Janar – Dhjetor të vitit 2021. Pyetjet janë organizuar në 3 blloqe të ndryshme.


- **Blloku i parë i pyetjeve** mundëson mbledhjen e të dhënave konkrete mbi kushtet dhe respektimin e të drejtave të gazetarëve në vendin e punës. Ky bllok paraqet të dhëna mbi marrëdhënien kontraktuale në punë, kohëzgjatjen e kontratës, pushimet javore dhe ato vjetore, si dhe mbi nevojën për ngritjen e një sindikate për të mbrojtur të drejtat e tyre në punë.
- **Blloku i dytë i pyetjeve** mundëson mbledhjen e të dhënave mbi situatën dhe faktorët që ndikojnë në lirinë profesionale të punonjësve të medias. Këtu përfshihen edhe faktorë si kërcënimet gjatë ushtrimit të profesionit, stresi apo tronditjet psikologjike si pasojë e punës apo ndikimi që kanë punëdhënësit/redaktorët në transmetimin e ngjarjeve.
- **Blloku i tretë i pyetjeve** përmban pyetje për mbledhjen e të dhënave mbi faktorët që sipas punonjësve të sektorit ndikojnë në lirinë e medias, si dhe sugjerimet e tyre mbi masat që do të ndihmonin më shumë rritjen e lirisë së medias.

Barometri pasqyron gjithashtu të dhënat e mbledhura nëpërmjet kërkesave për informacion drejtuar disa gjykatave në vend, lidhur me numrin e çështjeve gjyqësore (civile apo penale) me pale ndërgjyqëse ose të pandehur gazetar dhe punonjës të sektorit të medias, progresit të këtyre çështjeve dhe vendimmarrjes për to, nëse ka patur, për periudhën Janar – Dhjetor 2021.

4. Të dhëna të përgjithshme për të anketuarit

Të dhënat e kategorizuara për personat që i janë përgjigjur Barometrit, pasqyrohen në vijimësi:


a) Gjinia



105 e të anketuarve apo 52.5% e tyre ishin vajza dhe gra, ndërsa 95 apo 47.5% e totalit ishin burra.

b) Moshë

Fig.2 Ndarja e të anketuarve sipas moshës



Shumica e të anketuarve rezultojnë me përvojë në sektorin e medias. Afro 2/3 ose 66% e atyre që i janë përgjigjur Barometrit, referojnë se kanë mbi 10 vjet që ushtrojnë profesionin.

Në krahasim me Barometrin 2020, përvoja e të anketuarve ruan thuajse të njëjtën strukturë. Konkretisht disa prej të dhënave pasqyrohen si vijon:

- Më shumë se 1/3 e tyre apo 38 % referojnë se kishin mbi 15 vjet përvojë.
- 28% e të anketuarve kishin 10-15 vjet përvojë.
- 13.5% e të anketuarve kishin 5-10 vjet përvojë.
- 19% kanë 1-5 vjet përvojë.
- ndërkohë që 1.5% e totalit kishin më pak se një vit që punojnë në sektorin e medias.

d) Pozicioni

Në sondazh u përfshinë punonjës të medias që ushtrojnë profesionin në pozicione të ndryshme. Në Barometrin 2021 të anketuarit që u vetëdeklaruan gazetarë, kryeredaktorë dhe redaktorë kanë një rritje me 5%, në raport me Barometrin 2020. Rreth 61.5% e tyre u vetëdeklaruan gazetarë, 10.5% kryeredaktorë dhe 8.5% redaktorë. Pjesa tjetër, prej rreth 15% përfshinin punonjës në pozicione të tjera, si: Regjisorë, montazhierë, kameramanë, teknikë transmetimi, etj.

e) Shpërndarja gjeografike

Të dhënat e kategorizuara sipas moshës së të anketuarve evidentojnë se:

- 25% e tyre i përkisnin grupmoshës 20-30 vjeç
- 48% bënë pjesë në grupmoshën 30-40 vjeç
- 24% i përkisnin grupmoshës 40-50 vjeç
- 2.5 % në grupmoshën 50-60 vjeç
- 2.5% ishin mbi 60 vjeç.

c) Përvoja në sektorin e medias

Fig.3 Ndarja e të anketuarve sipas viteve të eksperiencës në punë







Fig.4 Ndarja e të anketuarve sipas pozicionit në punë



Të dhënat tregojnë një epërsi të përfaqësimit gjeografik në qendër, sa i takon faktit se 82.5% e të anketuarve pohojnë se punojnë në Tiranë, duke reflektuar një rritje me 8,5% të këtij treguesi në krahasim me vitin e kaluar. Ndërsa 17.5 % e tyre referuan se punonin në qytete të tjera të vendit. Edhe pse pyetësi u është dërguar një numri të njëjtë punonjësve të medias në rrethe si ai i vitit të kaluar, numri i përgjigjeve nga kjo kategori është më i ulët.

f) Kategorizimi i medias

Barometri u shtri në të gjithë territorin e vendit, duke përfshirë punonjës të mediave lokale, kombëtare, rajonale dhe atyre ndërkombëtare. Ky kategorizim nuk reflekton domosdoshmërisht vendndodhjen gjeografike të të anketuarve, por llojin e medias për të cilën ata punojnë. Siç tregohet në figurën 6, rreth 79.5 % e të anketuarve pohuan se ishin të punësuar apo angazhuar më mediat kombëtare duke reflektuar një rritje me 5%, krahasuar me vitin 2020. Një rritje me 3 % ka pësuar edhe angazhimi me mediat ndërkombëtare, në radhët e të pyeturve, e për pasojë evidentohet ulje e punësimit apo angazhimit me mediat lokale apo ato rajonale (përkatësisht ulje me 3 % dhe 6%).




Sa i takon kategorizimit të medias, pjesa më e madhe e të anketuarve, në masën 73.5%, rezultojnë të punësuar apo të angazhuar në një prej televizioneve në vend, duke reflektuar një rritje të lehtë nga viti 2020. Media online e përfaqësuar në këtë anketim angazhon më shumë gazetarë e punonjës se sa media klasike e shkruar pasi vërehet se 9.5% e të anketuarve punonin në portale online ndërkohë që 8% e të anketuarve punonin në median e shkruar (përkatësisht 7.5% në gazetë dhe vetëm 0.5% në revistë). Gjithashtu, 3.5% e pjesëmarrësve në sondazh ishin të vetëpunësuar (freelance), ndërsa 4.5% u deklaruan se punonin në organizata të shoqërisë civile, duke reflektuar një rritje me 3% nga të dhënat e vitit 2020.


5. Respektimi i të drejtave të gazetarëve në vendin e punës

5.1. Informaliteti në punë

Për të kuptuar më shumë për nivelin e garantimit dhe respektimit të të drejtave të punonjësve të medias në punë, fillimisht të anketuarit u pyetën mbi marrëdhënien kontraktuale me punëdhënësin e tyre. Anketimi nxjerr në pah se ka një përmirësim të informalitetit të plotë dhe atij të pjesshëm në drejtim të marrëdhënies së punës, ndonëse ky fenomen i analizuar në tërësi është prezent e në nivele të konsiderueshme.



- 84% e të anketuarve pohuan se punojnë bazuar në një kontratë të rregullt pune, ndërsa pjesa tjetër prej 16% deklaruan se nuk kanë një kontratë të rregullt pune apo nuk kanë informacion për marrëdhënien e tyre kontraktuale. Këto shifra tregojnë një përmirësim të marrëdhënieve kontraktuale të punës me punëdhënësin në raport me një vit më parë ku reflektohet një rritje me 15.2% të punonjësve të medias (në radhët e të anketuarve), të cilët punojnë bazuar në një kontratë të rregullt pune.




Lidhur me kohëzgjatjen e kontratës:

- vetëm 42.5% e të anketuarve u përgjigjën se kanë një kontratë pune pa afat, një shifër thuajse e njëjtë me një vit më parë.
- 29.5% e të anketuarve u përgjigjën se kanë kontratë me afat 1-vjeçar,
- 16.5% deklaruan se nuk kishin informacion
- 5% deklaruan se janë me afat 3 vjeçar
- 6% deklaruan se nuk disponojnë një dokument të tillë.

Këto të dhëna të cilat nuk përputhen plotësisht me tablonë e mësipërme, tregojnë se në sektorin e medias vijojnë praktikën e informalitetit të punonjësve të padeklaruar në nivele më të larta se ata raportojnë efektivisht

ose ka një mungesë informacioni dhe disponimi të dokumentacionit (kontratës së punës) dhe të drejtat që rrjedhin prej saj. Vlen të theksohet se 16.5% e të anketuarve deklarojnë se nuk janë në dijeni të kohëzgjatjes së kontratës së tyre. Kjo shifër mund të jetë tregues i një fenomeni shqetësues në media, që ndonëse punonjësit firmosin dokumentin, nuk njihen me përmbajtjen e plotë të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kontrata, e cila nisur nga ky tregues mund të mos iu vihet në dispozicion një kopje e saj, sikurse parashikon legjislacioni në fuqi.

Fig.10 Deklarimi i pagës reale pranë organeve tatimore



Mosdeklarimi i pagës reale pranë organeve tatimore prek edhe sektorin e medias. Konkretisht 21.5% e të anketuarve kanë pohuar faktin shqetësues se nuk e marrin të plotë pagën në bankë, çka përbën shkelje të nenit 118 të Kodit të Punës. Megjithatë vërehet një përmirësim i situatës në këtë drejtim me 9,5%, pasi krahasuar me të dhënat për vitin 2020, 31% e të anketuarve që pohuan se një pjesë të pagës e merrnin “në dorë”.

Mosdeklarimi i pagës së plotë ka një efekt të dyfishtë negativ si për individin ashtu edhe për institucionet shqiptare. Përveç shmangies së

detyrimeve tatimore si dhe pagesave të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, e cila përbën shkelje flagrante të legjislacionit në fuqi¹¹, ndikon negativisht edhe në përfitimet direkte afatshkurtra dhe afatgjata për punonjësit e medias, si reduktimi i të ardhurave në rast barrë lindje, paaftësie nga sëmundjet apo mospërfitimin e plotë të pensionin të pleqërisë¹², duke qënë se këto pagesa bëhen mbi bazën e pagës së deklaruar të punonjësit¹³.

4.2. E drejta për pushime javore dhe vjetore

Edhe kur bëhet fjalë për pushimet javore dhe vjetore të garantuara nga Kodi i Punës, evidentohet se shumica e punonjësve të medias punojnë mbi normën e lejuar përgjatë një jave, ne mungesë të pushimeve të mjaftueshme gjatë një jave kalendarike. Konkretisht, 63.5% e të anketuarve deklarojnë se punojnë 6 ditë në javë, me një rritje prej 4,5 % në krahasim me vitin 2020, ndërkohë që 14.5% e të anketuarve deklarojnë se nuk bëjnë asnjë ditë pushim, duke shënuar një ulje të lehtë me 3,5% të këtij indikator në krahasim me vitin 2020. Për punonjësit që kanë 10-15 vjet përvojë në punë, vihet re gjithashtu një raportim i lartë i të punuarit përgjatë 7 ditëve të javës, çka tregon se shkelja e të drejtave të përcaktuara në Kodin e Punës nuk bën diferencim mes punonjësve të rinj dhe të vjetër.

Të dhënat gjithashtu tregojnë një rritje me 7% të numrit të punonjësve të medias që punojnë 5 ditë në javë, në krahasim me Barometrin 2020. Më konkretisht, 20% e të anketuarve deklaruan se


¹¹ 20 Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar dhe neni 117 i Kodit të Punës

¹² Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

¹³ Neni nr. 26; 27; 28; 29, i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

punojnë 5 ditë në javë, ndërkohë që 2% e tyre deklarojnë se punojnë sipas rastit, në varësi të kontratës apo zhvillimeve.

Shkeljet lidhur me pushimet reflektohen edhe sa i takon pushimeve vjetore, të cilat sipas “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” duhet të zgjasin jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim”¹⁴. Por, 73% e punonjësve deklaruan se bëjnë më pak pushime vjetore se sa përcakton Kodi i Punës, por megjithatë duke reflektuar një përmirësim prej 2% të respektimit të kësaj të drejte. 57% e të pyeturve deklaruan se bëjnë 14 ose 15 ditë pushim në vit, ndërkohë që 3% e të anketuarve deklaruan se nuk bëjnë fare pushime vjetore. Të dhënat tregojnë se vetëm 27% e punonjësve gëzojnë efektivisht të drejtat për leje të plotë vjetore.




4.3. Bullizmi/tallja në vendin e punës

Të dhënat mbi bullizimin dhe/apo talljen në vendin e punës referohen thujtë të njëjta me gjetjet e Barometrit 2020.

- Rreth 12.5% e të anketuarve pohuan se ishin bullizuar/tallur gjatë punës apo për shkak të saj, në ambientin e punës, një e dhënë që ka pësuar rritje me 1% në raport me një vit më parë. Nga 25 persona që pohuan bullizimin, 15 prej tyre kishin më shumë se 10 vite eksperiencë në punë. Të anketuarit referojnë se autorë të sjelljeve bullizuese apo tallëse janë eprorët e tyre.

Fig.13 Prezenca e fenomenit të talljes te punonjësit e medias

A jeni ndjerë ndonjëherë i bullizuar/tallur në ambientin e punës?




¹⁴ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar

Ndër shkaqet e bulëzimit apo të talljes referohet gjinia, origjina¹⁵, mosha, veshja dhe pamja e jashtme, mungesa e eksperiencës, shëndeti apo deri edhe për shkak të jetës personale e private.

4.4. Ngacmimet seksuale në vendin e punës


Veç bullizimit apo talljes, 8 punonjës të medias apo 4% e të anketuarve deklaruan se ishin ngacmuar seksualisht në vendin e punës. Në krahasim me Barometin 2020, numri i të anketuarve që referojnë ngacmime seksuale në vendin e punës ka pësuar rënie me 3.5%. Të anketuarit që



pohuan ngacmime seksuale ishin vajza/gra dhe burra, ndryshe nga anketimi i një viti më parë ku rastet e ngacmimeve seksuale u referuan vetëm nga vajzat dhe grantë. Disa prej gazetarëve kanë pohuar forma të ngacmimit seksual si: “Kërkonte favore seksuale në këmbim të vendit të punës” apo “Më kanë kërkuar takime urgjente pune gjatë fundjavës disa here si dhe afrimet fizik”.

4.5. Nevoja për krijimin e Sindikatës së Punonjësve të Medias

Kodi i Punës të RSH-së në nenin 176 të tij parashikon organizim në sindikata të punëmarrësve dhe punëdhënësve, ku thuhet se “Organizatat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve janë organizata



shoqërore të pavarura, që krijohen si bashkime vullnetare të punëmarrësve ose punëdhënësve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të tyre”. Ndërkohë që në Kod parashikohet edhe menyra për krijimin e këtyre organizatave. Në dispozitat vijuese parashikohet ndër të tjerash, menyra dhe procedurat e krijimit të organizatave sindikale.¹⁶


¹⁵ Një gazetar referoi përdorimin e shprehjeve tallëse me bazë origjinën si “Ju nga rrethet, a e keni parë veten në pasqyrë.”

¹⁶ Elementët që duhet të mbajë statuti i tyre, kufirin minimal të anëtarëve themelues të tyre (përkatësisht jo më pak se 20 anëtarë për sindikatat), fitimin e personalitetit juridik pasi organizata të ketë depozituar aktin e themelimit dhe statutin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, parimet që udhëheqin këto organizata, ku ndër më të rëndësishmit është se zgjidhja e kontratës së punës, nga punëdhënësi, për përfaqësuesit e organizatës sindikale, pa pëlqimin e kësaj organizate, është e pavlefshme, etj.

Punonjësit e medias pothuajse në unanimitet pohojnë nevojën për krijimin e një sindikate për të mbrojtur efektivisht të drejtat e tyre në punë. Konkretisht, 194 apo 97% e të anketuarve ishin pro ngritjes së saj (me një ndryshim të papërfillshëm prej 1% nga viti i kaluar). Ndërkohë vetëm 1 punonjës është përgjigjur me “jo” krijimit të sindikatës, e dy prej tyre shprehen se nuk e dinë efektivitetin e sindikatës.

- 85.5% e të anketuarve, pohuan gjithashtu se do të ishin pjesë aktive e sindikatës, ndërkohë 10.5% e tyre shprehen të pasigurt (nuk e di), nëse do të ishin pjesë e saj. Të dhënat janë thuajse të njëjta me Barometrin 2020.

Organizimi në një sindikatë i punonjësve të medias reflekton nevojën e menjëhershme të shprehur nga vetë ata, për përmirësimin e të drejtave të punës së punonjësve të medias. Duke vlerësuar përpjekjet e shoqatave të ndryshme të medias në Shqipëri, për organizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve, grupimet e krijuara nuk janë formalizuar në krijimin e një sindikate, duke ndikuar edhe në mbartjen vit pas viti të problematikave dhe shkeljeve të të drejtave në marrëdhëniet e punës, të cilat vijojnë të jenë në nivele shqetësuese.




6. Liria profesionale

6.1 Kërcënimet për shkak të punës

Ashtu si në vitin 2020, edhe për vitin 2021, Barometri evidenton se ka patur raste të shpeshta ku gazetarët e punonjësit e medias kanë qënë subjekt i kërcënimeve fizike dhe verbale. Kushte të tilla favorizojnë një klimë censure apo autocensure ndaj medias në vendin tonë. Ndërkohë, në krahasim me vitin e kaluar deklaratimet për kërcënime fizike e verbale janë rritur, përkatësisht nga 33% në 34.5%.


Të anketuarit referojnë se autorë të sulmit, apo personat ndaj të cilëve janë ndjerë të kërcënuar, janë si punonjës të institucioneve shtetërore (punonjës të policisë, garda e republikës, shoqërues të zyrtarëve të lartë etj) ashtu edhe persona privatë (protagonistë të ngjarjeve të raportuara, persona të lidhur me botën e krimit). Ndërkohë format e kërcënimeve fizike dhe verbale kanë qënë të ndryshme ku punonjësit e medias kanë evidentuar raste të tilla si: dërgimi i mesazheve kërcënuese, dhunë fizike nga punonjësit e policisë, përdorimi i shprehjes “kazan”, thyerja e mjeteve të punës,



kërcënime me armë deri në kërcënime absurde si tritol në banesë.

Gjatë vitit që shkoi, në media janë raportuar edhe raste kur policia ka shoqëruar disa orë gazetarë që ishin në krye të detyrës, siç ishte rasti i gazetarit Ergys Gjencaj¹⁷. Kjo konfirmohet edhe nga disa prej të anketuarve, të cilët referojnë se janë kërcënuar apo ndjerë të kërcënuar prej policisë apo gardës.

Të dhënat statistikore të Barometrit reflektojnë se, 34.5 % e të anketuarve kanë patur kërcënime fizike për shkak të punës apo gjatë kryerjes së saj. Këto të dhëna kanë pësuar rritje me 1.5% në raport me një vit më parë.



Pavarësisht këtyre treguesve, shqetësuese mbetet fakti se autorët e dhunës nuk ndëshkohen ose ndaj tyre janë dhënë sanksione tepër të buta, në raport me shkeljen e pretenduar. Koncretisht, nga rastet e ndjekura ligjërisht nga KShH rezultojnë se:

✚ Për gazetarin Ergys Gjencaj, nga përgjigja e Policisë rezultojnë se në përfundim të inspektimit të veprimeve të punonjësve të policisë, i është rekomanduar Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë të ndëshkojë me masë disiplinore “vërejtje” katër punonjës policie që kanë qënë të përfshirë.

✚ Për gazetarin Elvis Hila, në përfundim të hetimit disiplinor ka rezultuar se veprimet e punonjësit të policisë Komisar A.C për ndërhyrjen dhe largimin nga zona e perimetrit të sigurisë dhe shoqërimin e gazetarit tëk mjeti i policisë është bërë në zbatim të detyrave për mbarëvajtjen dhe mbështetjen e veprimeve të IKMT-së. Por sipas autoriteteve, shkelja e kryer nga punonjësi i policisë është e natyrës etike. “Nga pamjet filmike rezulton se punonjësi i policisë, në komunikimin me dy gazetarët shfaqet i zbërthyer dhe pa kapele, sjellje që demtojnë imazhin e organizatës së policisë dhe janë në kundërshtim me nenin 117 të Kodit Etik. Për këtë arsye, A.C është ndëshkuar me masën disiplinore “Vërejtje” me motivacionin “Për shkelje të lehtë disiplinore” neni 197 pika 2 germa C “Për pakujdesi në detyrë”.


¹⁷ <http://gazetashqiptare.al/2021/07/27/policia-shoqeron-gazetarin-e-nees-24-gjoncaj-po-beja-punen-time-shtrine-barkas/>

Ndërkohë, 52.5% e të anketuarve pohojnë se janë kërcënuar verbalisht. Format me të cilat është kryer kërcënimi verbal, referohen të jenë me mesazhe telefonike, përmes mesazheve në rrjetet sociale apo edhe ballë për ballë. Si në rastet e kërcënimeve fizike, autorët e kërcënimeve verbale janë të njëjtë, punonjës të institucioneve shtetërore (policia, apo edhe deputetë të Kuvendit, sipas pohimeve të një gazetari). Kërcënimet verbale kanë shënjestruar vetë gazetarët por edhe familjarët e tyre, ku referohen kërcënime si “Mos fol, a ke familje, mos permend emrin tim, po te shohim kujdes çfarë thua” apo “Na kanë kërcënuar me familje, apo që do ta pësojmë personalisht.”

Të pyetur nëse kishin gjetur mbështetje nga punëdhënësit në raste të kërcënimeve fizike apo verbale, 50 % e punonjësve të medias pohuan se kanë pasur mbështetje në këto raste me një rritje prej 4% nga të dhënat e vitit të kaluar, ndërkohë 24% referojnë se nuk kanë patur mbështetjen e punëdhënësit duke reflektuar një rënie prej 2,5% nga viti 2020 dhe 26% kanë plotësuar alternativën “Nuk e di”.

Fig.19 Mbështetja nga punëdhënësi

A jeni ndjerë ndonjëherë i kërcënuar verbalisht si pasojë e punës tuaj?



■ Po ■ Nuk e di ■ Jo


6.2. Stresi dhe situatat traumatike

Stresi dhe situatat traumatike janë prezentë përgjatë punës së gazetarëve dhe punonjësve të medias. **Kjo vërtetohet nga 87 % e të anketuarve të cilët raportuan nivele të larta stresi për shkak të punës, një e dhënë thuajse e njëjtë me Barometrin 2020 (88%).**

68% e të anketuarve, ose 11% më pak në raport treguesin e mësipërm, pohuan se kishin mbuluar dhe raportuar ngjarje, të cilat u kishin krijuar tronditje të fortë psikologjike. Pavarësisht nga kjo shifër, vetëm rreth 6% e tyre pranuan se kishin kërkuar ndihmë mjekësore për tronditjen apo traumën e përjetuar. Kjo shifër është edhe më e ulët, në krahasim me Barometrin 2020, ku kërkesa e ndihmës mjekësore u pohua nga 10% e të anketuarve. Disa nga të anketuarit që kishin kërkuar ndihmë, referuan se u janë drejtuar psikologëve, kardiologëve apo neurologëve.

Fig.19 Përjetimi i stresit për shkak të punës.

A keni përjetuar ndonjëherë nivel të lartë stresi si pasojë e




■ Po

6.3. Censurë dhe vetëcensurë

Krahasimisht me vitin 2020, të dhënat e këtij barometri (2021) evidentojnë një rënie të lehtë të censurës direkte dhe indirekte. Numri i atyre që pohuan se ishin censuruar pasi u ishte kërkuar direkt nga pronari apo përmes redaktorit apo kryeredaktorit të mos publikonin një lajm, ra me 4%, nga 49.5% në vitin 2020 në 45.5% në vitin 2021. Konkretisht, 70 prej të intervistuarve referuan


rastet kur kjo kishte ndodhur, kryesisht për ngjarje apo çështje që kanë qenë në vëmendje të publikut. Ndër rastet e përmendura si censurë janë raportimet për koncensionet dhe punët publike, raportimet në lidhje me inceneratorët dhe problemet që pasuan dhe më të shpeshta janë kauzat që preknin direkt interesat e lidhura me biznesin e punëdhënësit.

“Ka shumë raste të tilla, por kryesisht janë kur preken interesat indirekte të financuesit”, - thotë



një prej të anketuarve. Ndërsa një tjetër i pyetur përmend një sërë temash “tabu”. *“Rastet e kronikave investiguese në fushën e naftës, rastet e kronikave në fushën e financave publike apo në rastet e analizave të sektorit energjetik. Rastet e ndalimit (censurës) kanë qenë të përjavshme”, - shkruan i/e anketuari.* Një tjetër i anketuar evidenton se rastet e censurës vinin për shkak të kompanive të tjera të pronarit të medias. *“Aktualisht kompania mediatike ku punoj ka firmë ndërtimi, e cila administron tenderë për punë publike, për të cilët thjesht nuk mund të raportoj”, - thotë i anketuari.* Megjithatë edhe mes atyre që e pranojnë censurën, një pjesë janë lakonikë në dhënien e rasteve.

Një përmirësim të lehtë, ka edhe sa i përket lënies në mes të një investigimi apo të punës për një lajm. Konkretisht, nga 33.5% që kishin raportuar se ishin përballur me një situatë të tillë në Barometrin për vitin 2020, në 31.5% në Barometrin e realizuar për vitin 2021. Rastet e referuara nga 54 prej të anketuarve përputhen me ato për të cilat u ishte ndaluar raportimi. Edhe në këtë drejtim, bie në sy çështja e inceneratorëve, raportimi për arrestime personash të njohur publikë dhe




po ashtu çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e fondeve publike të rindërtimit.


Shqetësues është fakti se numri i atyre që u përballën me kërkesa për të prodhuar një raportim të rremë u rrit përgjatë vitit 2021. Në vitin 2020, 8% e të pyeturve pohuan se u ishte kërkuar të publikonin lajme të rreme, ndërsa për 2021, 10.5% e të pyeturve pranuan se kishin marrë një kërkesë të tillë. 7% e të pyeturve nuk ishin të sigurt nëse

kjo kishte ndodhur, duke përcjellë dyshime serioze se edhe mund të ketë ndodhur.

Përmirësimi më i ndjeshëm në këtë kategori duket se është vetëcensura. Numri i atyre që kanë pranuar se kishin shmangur raportimin e një lajmi për shkak se kishin menduar se ai nuk do i pëlqente punëdhënësit ra nga 52% në vitin 2020 në 45% në vitin 2021. Ndërkohë 48% thanë se kjo nuk kishte ndodhur krahasuar me 42% në pyetësin e Barometrit të një viti më parë (2020). 7% nuk ishin të sigurt për përgjigjen.



Ndërkohë, numri i atyre që kanë pohuar se vetë censuroheshin për shkak të frikës së humbjes së vendit të punës është rritur me një vit më parë, nga 30.5% në 32.5%. Në përgjigjet e kësaj pyetje reflektohet pasiguria mes gazetarëve dhe punonjësve të medias, sa i përket pasojave që mund të ketë raportimi i tyre. Konkreisht, 50.5 % e të pyeturve kanë pranuar se kishin frikë (32.5%) apo nuk i dinin pasojat pas publikimit të një lajmi (18%) që mund të mos pëlqejë nga botuesi apo eprorët.



Ndërkohë, vitin që shkoi ka pasur një sërë padish ndaj gazetarëve në gjykatë, kryesisht me akuza për shpifje, madje edhe një rast të dënimit, gazetarët e Bold Neës¹⁸. Ky indikator është pasqyruar edhe në përgjigjet e rreth 12.5% e të pyeturve në kuadër të Barometrit, të cilët kanë pohuar se do të vetë-censuroheshin nga frika se mund të paditeshin në gjykatë.

Siç del edhe më poshtë në këtë Barometër një pjesë e mirë e gazetarëve tentojnë ta shmangin gjykatën, duke iu “trembur” burokracive dhe problemeve që kjo mund t’iu krijojë.

7. Vlerësimi i lirisë së medias

¹⁸ parlament.al/Files/Procesverbale/20220308133025Procesverbal%20%2015%20shkurt%20%202022.pdf

Por ndërsa duket sikur ka një përmirësim të lehtë të situatës së gazetarëve në përgjigjet e pyetjeve më sipër, në këtë seksion të tretë, mbi perceptimin e gazetarëve dhe punonjësve të medias sa i përket lirisë së shprehjes në vend gjatë vitit 2021, të dhënat e mbledhura tregojnë një përqendrim të gjendjes.


Një shpjegim për këtë mund të jetë diferenca mes perceptimit për situatën personale dhe atë të medias në tërësi. Një raport i BIRN në vitin 2017¹⁹ mbi këtë temë vë në dukje se gazetarët e censurojnë të vërtetën kur pyetja është direkt për ta dhe punën e tyre, ndërsa kanë një perceptim se ajo ndodh më shumë në raport me të tretët, duke patur parasysh kolegët apo media të tjera nga vendi i tyre i punës.

Përgjigjet e marra në këtë seksion tregojnë se faktorët, që sipas punonjësve të medias ndikuan në përqendrimin e lirisë së medias nuk kanë ndryshuar. Nga ana tjetër, përgjigjet dhe ndryshimi i vogël nga viti i kaluar nuk duket se reflektojnë humbjen e 20 vendeve në raportin e “Reporterë pa Kufij”. Në këtë seksion të pyeturit kanë dhënë edhe sugjerimet tyre mbi mënyrat se si mund të ndryshohet kjo situatë, ku theks i veçantë është vendosur tek trajnimet dhe edukimi më i mirë i gazetarëve.

7.1. Perceptimi mbi lirinë e medias dhe tendenca, me vitet e kaluar

Pjesa më e madhe e të anketuarve apo 68% e tyre mendojnë se media në Shqipëri është pak ose aspak e lirë, me një përqendrim në masë të lehtë me 1.5% nga Barometri i vitit 2020 (një vit më parë). Ndërkohë që 28% e vlerësuan median si mesatarisht të lirë. 4% e të anketuarve mendojnë se media në vend është e lirë apo plotësisht e lirë.

Fig 24. Perceptimi mbi nivelin e lirisë së medias




7.2. Ngjarjet (faktorët) ndikues

Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, të anketuarve iu kërkua të zgjidhnin deri në 3 alternativa, nga e para më kryesorja, te e treta, për faktorët ndikues në cenimin e lirisë së medias, duke lënë mundësinë e shtimit të faktorëve të rinj nëse ata e gjenin të arsyeshme. Edhe pse me një ndryshim në përqindje, renditja e faktorëve për keqësues mbeti e njëjtë me vitin e kaluar.

Me një rënie prej 6% nga viti i kaluar, 83.5% e gazetarëve dhe punonjësve të medias mendojnë se ndërhyrjet e qeverisë apo partive politike janë faktori kryesor që cenon lirinë e medias. Në vendin e dytë me 78.5% renditen interesat e bizneseve të drejtuara nga pronarët e mediave. Bizneset që reklamojnë në media dhe ushtrojnë ndikim negativ ishin të tretët me 35%, ndërsa përdorimi i medias për tu pasuruar ishte faktori i katërt me 33%. Më pak nga të anketuarit zgjedhën si alternativë të tretë krimin e organizuar dhe vetëm një përgjigje ishte mbi mungesën e drejtësisë.

¹⁹ <https://birn.eu.com/ep-content/uploads/2017/05/Raport-mbi-vetecensuren-ne-median-shqiptare.pdf>



Punonjësit e medias listuan një sërë ngjarjesh, që sipas tyre cenuan lirinë e medias përgjatë vitit 2021, në të cilat bie në sy vijimi i ndikimit të pandemisë apo përdorimit të saj për të kufizuar liritë, krijimi nga qeveria i Agjencisë për Media dhe Informim, e cila kufizon hapësirën që kanë gazetarët për të kërkuar prononcime të drejtpërdrejta nga përfaqësuesit e ekzekutivit, fushata zgjedhore dhe vijimi i traditës së kasetave të gatshme, ngjarje si ajo e inceneratorëve, arrestimi i politikanëve të njohur dhe dhuna verbale ndaj gazetarëve prej kryeministrit apo politikanëve të tjerë. Përpjekja për të sekuestruar serverat e Lapsi.al pas publikimit të lajmit për patronazhistët gjatë fushatës elektorale, është parë po ashtu si një moment përkeqësimi të situatës, për të cilën reagoi edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut duke marrë një masë të ndërmjetme për urdhërimin e autoriteteve për të mos marrë të dhënat nga portali, si masë për të garantuar lirinë e shprehjes.

Ndërkohë lidhur me faktorët përmirësues, shumica e të anketuarve pohojnë se nuk janë në gjendje të identifikojnë raste. Disa prej tyre, megjithatë kanë përmendur rezistencën e vetë gazetarëve dhe të tjerëve, mbështetjen nga jashtë dhe presionin ndërkombëtar dhe të organizatave jo qeveritare mbi qeverinë.

7.3. Gazetaria Cilësore

Gazetaria cilësore, si një faktor i rëndësishëm që kontribuon në garantimin e lirisë së medias, shënon rritje ose nivele të njëjta si një vit më parë, sipas shumicës së të anketuarve.


Në 30.5% të rasteve, ata pohojnë se gjatë vitit 2021, gazetaria cilësore ka qenë më pak prezente në media, 39.5% e tyre referuan se nuk ka ndryshuar, ndërkohë që 30% deklaruan se gazetaria cilësore ka qenë më prezente.



7.4. Aksesit në Gjykatë

Të intervistuarit renditën një sërë arsyes, që i pengojnë ata t'i drejtohen gjykatës nëse liria e tyre e shprehjes cenohet. Burokracitë në përballjen me gjykatën janë arsyeja kryesore sipas të anketuarve (63.5% të rasteve), ndjekur nga frika nga hakmarrja e punëdhënësit (55.5%). Këto të dhëna janë të njëjta me Barometrin për vitin 2020.

Arsyeja e tretë që ndikon në vendimin për të mos ju drejtuar gjykatës është frika se gazetari nuk do të punësohet nga punëdhënësi tjetër, për shkak të solidaritetit që ekziston në të tilla raste midis pronarëve të medias (53.5%), një e dhënë që ka pësuar rritje me gati 10% nga viti i kaluar.



Njëkohësisht me realizimin e sondazhit me gazetarët dhe punonjësit e medias, është kërkuar informacion zyrtar nga gjykatat e rrethave gjyqësore mbi të dhëna sa i takon numrit të çështjeve gjyqësore në proces, të pushuara, të pezulluara me palë gazetar apo punonjës të medias, si edhe natyrën e këtyre çështjeve, civile dhe penale, si edhe numrin e vendimeve të marra me palë gazetar

apo punonjës të medias, si edhe natyrën e këtyre çështjeve, civile dhe penale dhe kopje të anonimizuara të këtyre vendimeve.

21 gjykatat të cilat u kontaktuan dhe kthyen përgjigje ishin:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë

15 prej gjykatave të kontaktuara kanë referuar se për periudhën Janar – Dhjetor 2021 nuk kanë pasur çështje gjyqësore si edhe nuk janë dhënë vendime me palë përfaqësues të medias apo gazetarë.

1. **Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier** rezulton që për periudhën Janar - Dhjetor 2021 është regjistruar një çështje për kundravajtjen penale “Fyerja”. Gazetari ka qënë palë në këtë proces në cilësinë e të dëmtuarit akuzues. Ndërkohë, po për të njejtën periudhë, në këtë gjykatë rezulton të ketë pasur edhe një çështje civile me palë paditëse gazetarë, me objekt “*Marrëdhënie pune*”; për këtë çështje Gjykata e Fierit ka dhënë edhe një vendim gjyqësor. Një vendim tjetër i nxjerrë nga kjo gjykatë ku njëra nga palët ka qënë gazetar, rezulton të jetë rasti me objekt “*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*”, megjithatë ky rast nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë me profesionin e të pandehurit.
2. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**, nëpërmjet korrespondencës së dërguar na ka referuar vetëm një rast për veprën penale “*Shpifja*” ku palë të paditura janë dy televizione.
3. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**, ka raportuar vetëm një çështje me palë një individ të profesionit gazetar, për veprën penale “*Shpifja*” e cila është aktualisht në shqyrtim nga kjo gjykatë, megjithatë është e mbartuar nga viti 2020.

Ndërkohë Gjykata e Shkodrës, Gjykata e Durrësit dhe Gjykata e Tiranës kanë referuar se në bazë të formës së tyre të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave në këto tre gjykata, nuk kryhet një cilësim i profesionit të palës dhe nuk e kanë të mundur të evidentojnë çështjet me palë gazetarë apo punonjës të medias. Megjithatë nga verifikimi që mund t’i bëjnë të dhënave që ata disponojnë në këtë formë, nuk kanë evidentuar çështje me civile apo penale me palë gazetarë apo punonjës të medias.

7. Rekomandime

Të anketuarve iu kërkua të përzgjidhnin 3 alternativa mbi faktorët që kontribuojnë më shumë në rritjen e lirisë së medias dhe rrjedhimisht garantimit në nivele më të mira të saj.

Krijimi i një sindikate në mbrojtje të tyre të gazetarëve dhe përgatitja më e mirë profesionale e tyre, u përzgjedhën më së shumti nga të anketuarit (përkatësisht në 66% dhe 62.5%), si 2 faktorët kryesorë që kontribuojnë për rritjen e nivelit të respektimit të lirisë së medias në vend. Këto faktorë duket se kanë një lidhje të fortë me të drejtat e gazetarëve në punë dhe tregojnë siguri më të madhe në vendin e punës. Këta faktorë janë të njëjtët të zgjedhur më së shumti edhe në Barometrin e vitit 2020. Ndërkaq, mbështetja e mediave nga donacionet e huaj renditet si faktori i tretë më i rëndësishëm, i përzgjedhur nga 56% e të anketuarve duke u konsideruar se do të ndihmonte më shumë pavarësinë nga politika të lajmit. Në Barometrin e vitit 2020, ky faktor u përzgjedh nga 40% e të anketuarve. Kjo e dhënë ndryshon nga viti i kaluar, ku punonjësit e medias renditën në vend të tretë pavarësinë e pronarëve të medias nga politika.




Fig.27 Faktorët që do të ndihmonin rritjen e lirisë së medias

Lëvizja dhe organizimi sindikal apo çdo formë tjetër organizimi që do të ofronte mbrojtje për gazetarët dhe punonjësit e medias, sipas të anketuarve do të ndikonte në rritjen e lirive dhe po ashtu do të mundësonte më shumë siguri në punë.

Gjithashtu, të anketuarit evidentojnë se rritja e tyre profesionale, përmirësimi i kushteve të punës dhe shpërblimi financiar, do të ishin faktorë ndikues në cilësinë e medias në vend. Këto rekomandime, me ndryshime të vogla janë të njëjta me ato të një viti më parë.

Për të konkretizuar rekomandimet e adresuara nga vetë punonjësit e medias si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e adresuara më herët në raportin studimor për të drejtat e gazetarëve në

punë (publikuar në Maj të vitit 2020)²⁰ dhe Barometrin e Lirisë së Medias 2021²¹, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ri-konfirmon rekomandimet në vijimësi:

7.1. Rekomandime për punonjësit e Sektorit të Medias dhe Organizatat e Shoqërisë Civile Vendase dhe Ndërkombëtare

a. Mbështetja e vazhdueshme me trajnime që mundësojnë rritjen profesionale të punonjësve në sektorin e medias si dhe konkretizimi i një nisme për krijimin e një sindikate për punonjësit e këtij sektori. Të dyja rekomandimet janë të përsëritura dhe të mbartura nga dy vitet e kaluara, pasi situata mbetet e njëjtë dhe pa ndonjë zgjidhje konkrete në këtë drejtim.

Përpyjekjet për organizimin sindikal mbeten në “listën e dëshirave”, por veç disa tentative jo të formësuara, ende nuk ka një përpjekje që do të çonte në ngritjen e këtij mekanizmi apo çdo formë tjetër organizmi mbrojtës ndaj praktikave abuzuese apo jo të drejta që ndiqen brenda redaksive dhe po ashtu në një përgjigje më të fortë ndaj presioneve që shtyjnë drejt joprofesionalizmit apo mungesës së etikës.

Nga ana tjetër rekomandimet mbi profesionalizmin në këtë drejtim mbeten të njëjta, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në:

b. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i punonjësve në sektorin e medias mbi të drejtat dhe liritë e tyre sa i takon lirisë së shprehjes, si dhe të drejtat e detyrimit në drejtim të punësimit apo marrëdhënieve me të tretë institucionet shtetërore (institucionet shtetërore, subjekte politike, qytetarët, etj). Në këtë drejtim, rekomandohet fuqizimi dhe mbështetja për të reaguar ndaj çdo faktori që ndikon në cenimin e lirisë së medias.

c. Konsolidimi i mëtëjshëm i nismave të reja dhe ekzistuese vetë rregulluese, të qëndrueshme dhe impaktuese nga vetë punonjësit e sektorit të medias, është i nevojshëm për të forcuar kapacitetet, integritetin, qëndrueshmërinë, etikën dhe profesionalizmin e medias në vendin tonë.

d. Angazhimi dhe përfshirja e vazhdueshme e aktorëve të tjerë si shoqëria civile në vend dhe faktori ndërkombëtar në krijimin e mjediseve më të sigurta të punës për gazetarët dhe punonjës të mediave, përpjekjet e të cilëve konsiderohen pozitive në nxitjen e lirisë së medias.

e. Vijueshmëria e ofrimit të shërbimeve ligjore falas do të kontribuonte në motivimin e punonjësve të medias për ti ndjekur problemet që lidhen me punën e tyre përpara organeve administrative dhe gjyqësore, duke rritur besimin në këto institucione si dhe duke rritur aksesin e tyre në këto organe.

7.2. Rekomandime për përfaqësuesit e organeve publike dhe partive politike

²⁰ <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor-Te-drejta-pune-per-gazetaret-ALB-1.pdf>

²¹ <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Media-2020.pdf>

Nisur nga të dhënat e Barometrit, të cilat mbështesin edhe gjetje të organizatave ndërkombëtare (Reporter pa Kufinj), rezulton se roli i politikës në mjedisin mediatik në vend mbetet negativ. Gazetarët fajësojnë politikën për presione, censurën dhe krijimin e mjedisit jo të favorshëm të punës, përfshi ndikimin e pronarëve përmes kontratave publike. Rekomandimet në këtë drejtim mbeten të ngjashme, duke synuar në veçanti shmangien e ndikimit politik në gazetari:

a. Të shmanget çdo formë e ndërhyrjes në kundërshtim me garancitë e nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që garanton lirinë e shprehjes, veçanërisht kur këto vijnë nga ekzekutivi, legjislativi apo çdo përfaqësues i organeve publike si dhe përfaqësues të forcave politike në vend.

b. Megjithë kundërshtimin e profesionistëve të fushës, përfshire edhe rekomandimin në Barometrin e vitit 2021, Këshilli i Ministrave ngriti “Agjencinë e Medias dhe Informimit”. Pavarësisht se efektet e kësaj strukture nuk janë ende të qarta, gazetarët vijojnë të përballen me kufizim të aksesit në informacion dhe sulme verbale nga përfaqësues politik. Ndërsa mund të cilësohet pozitiv rikthimi i konferencave për shtyp prej ekzekutivit, përdorimi i tyre për të fyer dhe denigruar gazetarët që adresojnë pyetje të caktuara mbetet problematik. Marrëdhënia e ekzekutivit me sektorin e medias duhet të jetë mbështetëse ndryshe nga format e komunikimit të shfaqura në këto raste. Medias duhet ti garantohet një mjedis që të gëzojë plotësisht aksesin në informacion në institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, në kohën e duhur dhe që nuk dëmton aktualitetin e lajmit të vërtetë për publikun.

c. Shpërndarjen e lajmeve të parapërgatitura në kaseta dhe CD nga partitë politike gjatë fushatës apo përfaqësues të institucioneve publike dëmtuon rëndë profesionalizmin dhe raportimin e medias, dhuke cënuar të drejtën e publikut për t’u informuar në mënyrë të pavarur. Heqja dorë prej këtyre formave të komunikimit është nevojë urgjente dhe e përsëritur.

d. Nisur nga problematikat vijuese të punësimit të punonjësve të medias, KShH rekomandon institucioneve përgjegjëse si Inspektorati i Punës (ISHPSHSH) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe agjencive të tjera, rritjen e angazhimit me synim monitorimin objektiv, të paanshëm dhe joselektiv si dhe në mënyrë rigoroze të zbatimit të kuadrit ligjor nga ana e entiteteve private dhe atyre publike që prekin të drejtat e punës së punonjësve në media.

e. Tregu i medias në Shqipëri është i përqendruar ndjeshëm në duar të pak pronarëve të disa prej televizioneve kryesore që kanë shumicën e audiencës. Rekomandimi i hershëm i bërë edhe nga Komisioni Evropian dhe OSBE, për rikthimin e kuotës tavan për aksionet në mediat audiovizive, mbetet kyç për të krijuar një treg më pluralist.

Aneks 1

Lista e indikatorëve:

Seksioni i parë do të përmbajë tetë pyetjet e mëposhtme:

Të drejtat në punë:

1) A punoni bazuar mbi një kontratë të rregullt pune?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

2) Kontrata juaj e punës është me afat apo pa afat?

Me afat 1-vjeçar
Me afat (specifiko)
Pa afat

3) A e merrni të plotë pagën tuaj në bankë?

- d) Po
- e) Jo
- f) Nuk e di

4) Sa ditë në javë punoni?

5 ditë
Më pak, specifiko
Më shumë, specifiko

5) Sa ditë në vit merrni pushim?

6) A jeni ndjerë ndonjëherë i bullizuar/tallur në ambientin e punës?

- a) Po
- b) Jo

Nëse po, specifiko

7) A jeni ngacmuar ndonjëherë seksualisht nga dikush, nga i cili keni pasur varësi profesionale në ambientin e punës?

- a) Po
- b) Jo

Nëse po, specifiko

8) A është e nevojshme që gazetarët të kenë një sindikatë që do të mbronte të drejtat e tyre në punë?

- g) Po
- h) Jo
- i) Nuk e di

9) A do të ishit ju vetë pjesë aktive e kësaj sindikate?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

Liria profesionale:

Seksioni i dytë do të përmbajë 13 pyetjet e mëposhtme:

1) A jeni ndjerë ndonjëherë i kërcënuar fizikisht si pasojë e punës tuaj?

- j) Po
- k) Jo

Nëse po, specifiko

2) A jeni kërcënuar ndonjëherë verbalisht si pasojë e punës tuaj?

- a) Po
- b) Jo

Nëse po, specifiko

3) A jeni ndjerë i mbështetur nga punëdhënësi juaj në rastet e kërcënimit si pasojë e punës tuaj?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

4) A keni përjetuar ndonjëherë nivel të lartë stresi si pasojë e punës?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

5) A keni mbuluar dhe raportuar ngjarje, të cilat ju kanë krijuar tronditje të fortë psikologjike?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

6) A keni kërkuar ndonjëherë ndihmë mjekësore/psikologjike si pasojë e tronditjeve profesionale?

- a) Po
- b) Jo

Nëse po, specifikoni se ku.

- 7) A keni kërkuar ndonjëherë ndihmë nga ana e organizatave që mbrojnë të drejtat e mediave dhe gazetarëve për ndonjë situatë të pakëndshme që lidhet me punën tuaj apo profesionin?

a) Po
b) Jo

Nëse po, specifikoni se kur e keni kërkuar këtë ndihmë dhe a ju është dhënë ndihma që keni kërkuar.

- 8) A ju ka ndodhur që punëdhënësi t'ju ketë ndaluar direkt apo përmes eprorit tuaj të publikoni një lajm?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

- 9) A ka pasur raste, kur jeni urdhëruar të lini përgjysmë hulumtimin e një ngjarjeje?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

- 10) A ka pasur ndonjë rast kur ju është kërkuar të shkruani një lajm të rremë?

l) Po
m) Jo
n) Nuk e di

- 11) A ju ka ndodhur që të keni shmangur raportimin e një lajmi, sepse keni menduar se publikimi i tij nuk do t'i pëlqejë punëdhënësit/redaktorit tuaj?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

- 12) A keni frikë se publikimi i një lajmi, që mund të mos i pëlqejë punëdhënësit/eprorit tuaj, mund t'ju pushojë nga puna?

o) Po
p) Jo
q) Nuk e di

- 13) A jeni tërhequr ndonjëherë nga hulumtimi/publikimi i një lajmi, nga frika se do të paditeni në gjykatë?

r) Po
s) Jo
t) Nuk e di

Vlerësimi mbi lirinë e medias:

Seksioni i tretë do të përmbajë 10 pyetjet e mëposhtme:

- 1) Sa të lirë e vlerësoni median në Shqipëri në vitin 2021?
 - a) Plotësisht të Lirë
 - b) Të lirë
 - c) Mestarisht të lirë
 - d) Pak të Lirë
 - e) Aspak të lirë

- 2) Në raport me një vit më parë (vitin 2020) a mendoni se liria e medias:
 - a) Është përmirësuar
 - b) Është përkeqësuar
 - c) Nuk ka ndryshim

- 3) Nëse media për ju nuk është e lirë (mesatarisht, pak ose aspak e lirë), cilët janë faktorët kryesorë që pengojnë apo e cenojnë lirinë e medias? (zgjidh tre alternativa)
 - a) Ndërhyrjet e qeverisë apo partive politike
 - b) Interesat e bizneseve të drejtuara nga pronarët e mediave
 - c) Përdorimi i medias për t'u pasuruar
 - d) Bizneset të cilat reklamojnë në media
 - e) Krimi i organizuar
 - f) Faktorë të tjerë (specifiko)

- 4) Cilët janë faktorët që do të ndihmonin më shumë rritjen e lirisë së medias? (zgjidh tre alternativa)
 - a) Rritja e numrit të mediave në vend
 - b) Rritja e përgatitjes profesionale të gazetarëve
 - c) Krijimi i mediave në pronësi dhe drejtim të vetë gazetarëve
 - d) Krijimi i sindikatave në mbrojtje të gazetarëve
 - e) Mbështetja e mediave nga donacionet e huaja
 - f) Faktorë të tjerë (specifiko)

- 5) Në vlerësimin tuaj, cilat ishin një ose disa nga ngjarjet më të rënda që cënuan lirinë e medias përgjatë 2020-ës?

- 6) Në vlerësimin tuaj, cilat ishin disa nga zhvillimet të cilat i ndikuan rritjes së lirisë së medias përgjatë 2020-ës?

- 7) Cilët janë arsyet që pengojnë gazetarët t'i drejtohen gjykatës nëse liria e tyre e shprehjes cënohet: (zgjidh më shumë se një alternativë)
 - a) Nuk ka asnjë arsye
 - b) Mungesa e të ardhurave
 - c) Burokracitë në përballjen me gjykatën
 - d) Frika nga hakmarrja e punëdhënësit
 - e) Frika se nuk do të punësohet nga punëdhënësi të tjerë
 - f) Të tjera (specifiko)

- 8) Si e vlerësoni praninë e gazetarisë profesionale (cilësore) në vend gjatë vitit 2020?
- a) Ka qenë më prezente në media
 - b) Ka qenë më pak prezente në media
 - c) Nuk ka ndryshuar
- 9) Çfarë mund të bëhet për të përmirësuar cilësinë e gazetarisë në vend?
- 10) Çfarë mund të bëhet për të pasur sa më shumë shkrime/kronika cilësore në media?